

Prof. Dr. Nada Dollani

Propozuar nga Qendra A.L.T.R.I

Prof. Dr. Dollani është pjesë e personelit akademik pranë Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, e angazhuar si personel mësimor - shkencor prej vitit 2001 e në vijim.

Ka përfunduar studimet e larta në Drejtësi dhe studimet doktorale pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universitetit të Tiranës.

Pas mbrojtjes së doktoratës, Prof. Dr. Nada Dollani ka qenë e angazhuar në kërkimin shkencor në fushën e të drejtës private, pranë Institutit Max-Planck për të Drejtën e Krahasuar dhe Ndërkombëtare Private, Hamburg, Universitetit të Bolonjës, dhe institucioneve të tjera të njohura gjatë viteve 2010-2014. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka fituar bursa kërkimore nga Shoqëria Max Planck, DAAD dhe Erasmus Mundus.

Prof. Dr. Dollani ka qenë një anëtare aktive e Forumit të së Drejtës Civile për Europën Juglindore, mbështetur nga GIZ, i cili ka botuar një sërë volumesh të rëndësishme të punimeve shkencore në fushën e të drejtës civile. Fushat e saj kërkimore të interesit përfshijnë të drejtën e kontratave konsumatore europiane, kushtet e padrejta në kontratat konsumatore dhe ato standarde, antidiskriminimin në të drejtën private, etj. Ajo ka publikuar një numër artikujsh shkencorë në këto fusha. Në vitin e fundit Prof. Dollani ka zhvilluar një veprimtari të thelluar kërkimore në fushën e të drejtës së krahasuar si hulumtuese pranë dy institucioneve prestigjioze, Institutit të Studimeve Ligjore të Avancuara në Londër dhe Institutit Max-Planck për të Drejtën e Krahasuar dhe Ndërkombëtare Private në Hamburg.

Që prej vitit 2007, ajo ka qenë e angazhuar si eksperte e GIZ për implementimin e projekteve në mbështetje të Ministrisë së Ekonomisë për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të BE-së, në fushën e të drejtës ekonomike dhe të biznesit, të drejtës së konsumatorit, si dhe hartimin e propozimeve për projektligje dhe përmirësime ligjore.

Prof. Dr. Dollani ka qenë dhe është anëtare e bordeve, komisioneve, forumeve dhe organizatave të ndryshme operative në fushat e saj të ekspertizës, si: Anëtare e Këshillit drejtues të Institutit të së Drejtës Europiane, me qendër në Vienë, Austri (ELI); Anëtare e Bordit Editorial të revistës shkencore juridike rajonale "SEE Law Journal"; Anëtare e Forumit të së Drejtës Civile të Europës Juglindore, të ngritur nga GTZ/GIZ, aktiv gjatë viteve 2009-2014; Anëtare e shoqatës "Friends of the Hamburg Max-Planck Institute for Comparative and Private International Law".

Prof. Dr. Nada Dollani

Proposed by A.L.T.R.I Center

Prof.Dr. Dollani is a member of the academic staff at the Department of Civil Law, Faculty of Law, University of Tirana, engaged as teaching – scientific staff since 2001.

She completed her studies in Law and her doctoral studies at the Faculty of Law, University of Tirana.

After defending her doctoral thesis, Prof. Dr. Nada Dollani was involved in scientific research in the field of private law at the Max Planck Institute for Comparative and International Private Law in Hamburg, the University of Bologna, and other well-known institutions from 2010 to 2014. During this period, she received research grants from the Max Planck Society, DAAD, and Erasmus Mundus.

Prof. Dr. Dollani has been an active member of the Civil Law Forum for Southeast Europe, supported by GIZ, which has published a series of important volumes of scientific papers in the field of civil law. Her research interests include European consumer contract law, unfair terms in consumer and standard contracts, anti-discrimination in private law, etc. She has published several scientific articles in these areas. In the past year, Prof. Dollani has conducted in-depth research in the field of comparative law as a researcher at two prestigious institutions: the Institute of Advanced Legal Studies in London and the Max Planck Institute for Comparative and International Private Law in Hamburg.

Since 2007, she has been engaged as an expert for GIZ in implementing projects to support the Ministry of Economy in harmonizing Albanian legislation with the EU *acquis communautaire* in the fields of economic and business law, consumer law, as well as drafting proposals for draft laws and legal improvements.

Prof. Dr. Dollani has been and continues to be a member of various boards, committees, forums, and operational organizations in her areas of expertise, including: Member of the Governing Council of the European Law Institute, based in Vienna, Austria (ELI); Member of the Editorial Board of the regional legal scientific journal "SEE Law Journal"; Member of the Civil Law Forum for Southeast Europe, established by GTZ/GIZ, active from 2009 to 2014; and Member of the association "Friends of the Hamburg Max Planck Institute for Comparative and Private International Law."